

FAKTORËT ME NDIKIM NË MIRËQENIEN DHE PERFORMANCËN NË PUNË TË
MËSIMDHËNËSVE NË SISTEMIN PUBLIK PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM
NGA
FITORE JAKUPI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2024

FAKTORËT ME NDIKIM NË MIRËQENIEN DHE PERFORMANCËN NË PUNË TË MËSIMDHËNËSVE NË SISTEMIN PUBLIK PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

Mentore: Zamira Hyseni, Prof. Asoc. Dr.

Kandidate: Fitore Jakupi

Në vitet e fundit, mirëqenia dhe performanca në punë e mësimitdhënësve në sistemin e arsimit publik parauniversitar në Kosovë kanë marrë një rëndësi të veçantë për shkak të politikave të reja dhe kërkesave arsimore në zhvillim (Qendra për Arsim e Kosovës, 2021; Llapashtica-Lipscomb dhe Sahitaj, 2022). Ndryshimet e politikave arsimore që synojnë transformimin dhe përmirësimin e arsimit shpesh ndikojnë në mirëqenien e mësimitdhënësve. Kjo ndodh pasi presionet dhe sfidat që shfaqen me ndryshimin e politikave ndikojnë në cilësinë e mësimitdhënies, duke dërguar në ulje të kënaqësisë në punë, rritje të lodhjes emocionale dhe ulje të mirëqenies së mësimitdhënësve (Skinner et al., 2021).

Studimi në fjalë synon të eksplorojë faktorët që ndikojnë në mirëqenien dhe performancën në punë të mësimitdhënësve duke plotësuar boshllëqet në literaturën ekzistuese mbi këtë çështje. Në veçanti, ky studim synon të kuptojë se si ndryshimet në politikat arsimore ndikojnë në mirëqenien dhe efikasitetin profesional të mësimitdhënësve, të eksplorojë marrëdhënien e këtyre ndryshimeve me nivelin e kënaqësisë dhe stresit në punë të mësimitdhënësve, dhe të hulumtojë qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj burimeve të ofruara dhe mbështetjes profesionale.

Korniza Teorike- Në interpretimin e të gjeturave të këtij studimi janë përdorur 2 modele teorike. Modeli i kërkesave- burimeve për punë paraqet modelin e parë të zhvilluar nga Demerouti et al. (2001). Ky model përshkruan marrëdhëniet midis karakteristikave të punës, të ndara në kërkesa dhe burime, dhe rezultateve të punës, të cilat përfshijnë shëndetin, mirëqenien, motivimin dhe performancën. Në kontekstin e ndryshimeve të politikave arsimore, ky model sugjeron që rritja e kërkesave për mësimitdhënësit mund të çojë në stres dhe lodhje nëse nuk ka rritje të burimeve. Modeli i dytë teorik është Kuadri i Analizës dhe Zhvillimit Institucional (IAD), i hartuar nga Elinor Ostrom et al., (2005). Ky model lehtëson analizën e proceseve institucionale përmes të cilave ndodhin zgjedhjet individuale dhe kolektive (Ostrom, 2005). Modeli është zgjedhur sepse ofron një metodologji të strukturuar për të analizuar ndërveprimet komplekse midis aktorëve të ndryshëm dhe

rregullave institucionale, dhe ndihmon në kuptimin e ndikimeve të ndryshimeve të politikave arsimore në mirëqenien dhe efikasitetin e mësimdhënësve

Metodologjia

Ky studim përdori një dizajn kualitativ, duke mbledhur të dhëna përmes intervistave gjysmë të strukturuar me 62 mësimdhënës të punësuar në sistemin publik parauniversitar në Kosovë.

Intervistat gjysmë të strukturuar, pjesë projektit të Departamentit të Psikologjisë, udhëhequr nga Prof. Asoc. Dr. Zamira Hyseni, u analizuan përmes software-it Atlas.ti, duke identifikuar pesë tema kryesore. Për të siguruar besueshmërinë, u përdorën Alfa Krippendorff dhe Indeksi Holsti, me një analizë të kodimeve që rezultoi në pajtueshmëri të pranueshme.

Rezultatet

Nga analiza tematike janë identifikuar 5 tema kryesore:

- 1. Ndikimi i politikave në praktikën e mësimdhënies-**Mësimdhënësit kanë deklaruar se kanë hasur sfida si: përmbajtja e ngarkuar e kurrikulës, teknologjia e kufizuar në dispozicion për mësimdhënësit dhe mungesa e resurseve materiale dhe financiare. Ata kanë përcaktuar ndryshime në praktikën e tyre të mësimdhënies si rezultat i politikave të reja arsimore. Ndryshimet janë në disa fusha specifike si: rritja e teknologjisë në mësimdhënie, ndryshime në metodat e tyre të vlerësimit, dhe ndryshime në kurrikulë. Mësimdhënësit kanë deklaruar se kanë pasur përfitime nga politikat e reja arsimore në praktikën e tyre dhe zhvillimin e tyre profesional.
- 2. Qëndrimet ndaj burimeve dhe mbështetjes-**Shumica e mësimdhënësve deklarojnë mungesën e një mbështetjeje adekuate nga institucionet për të përballuar sfidat pas ndryshimit të politikave. Megjithatë, ka disa mësimdhënës, që raportojnë trajnime dhe mbështetje të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit, duke e cilësuar këtë mbështetje si të nevojshme dhe të vlefshme për zhvillimin e tyre profesional. Ata deklarojnë një qasje pozitive ndaj resurseve të reja, veçanërisht në kontekstin e trajnimeve të reja dhe zhvillimit profesional.
- 3. Mirëqenia e mësimdhënësve-** Shumica e mësimdhënësve kanë shprehur se politikat e reja kanë ndikuar negativisht në mirëqenien e tyre. Mësimdhënësit kanë deklaruar rritje të niveleve të stresit pas hyrjes në fuqi të politikave të reja arsimore si rezultat i kërkesave të reja dhe mungesës së përgatitjes së duhur për zbatimin e tyre. Në anën tjetër, ata kanë

deklaruar kënaqësi në punë ; të cilën e kanë lidhur me arritjen e qëllimeve me sukses dhe me daljen e nxënësve të suksesshëm nga procesi mësimor.

4. **Politikat e Shëndetit Mendor dhe Mirëqenies**-Mësimdhënësit i perceptojnë politikat e shëndetit mendor si një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë së përbashkët për mirëqenien e të gjithë pjesëmarrësve në shkollë. Sipas tyre politikat e shëndetit mendor kanë një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e nxënësve në shkollë dhe i ndihmojnë ata në tejkalimin e sfidave. Megjithatë, disa prej tyre shprehin nevojën për implementim më të zgjeruar që të sigurojnë një ambient pozitiv për shëndetin mendor të të gjithë palëve të përfshira në procesin arsimor.
5. **Roli dhe Perceptimi i Psikologëve Shkollorë**-Mësimdhënësit e vlerësojnë pozitivisht rolin dhe kontributin e psikologëve shkollorë në adresimin e sfidave arsimore. Ata gjithashtu e vlerësojnë ndikimin pozitiv të psikologut të shkollës në politikat dhe praktikat shkollore. Ata shprehin se psikologu shkollor është një burim i rëndësishëm i sqarimeve dhe mbështetjes emocionale për nxënësit.

Për të përmirësuar efektivitetin e politikave arsimore, rekomandohet pjesëmarrja aktive e mësimdhënësve në hartimin dhe zbatimin e politikave, si dhe mbështetja e tyre përmes trajnimeve të specializuara dhe resurseve të përkushtuara. Institucionet arsimore duhet të sigurojnë mbështetje të mjaftueshme materiale dhe financiare për mësimdhënësit dhe t'u ofrojnë mundësi për trajnime dhe zhvillim profesional. Gjithashtu, studimi sugjeron nevojën për strategji që ruajnë mirëqenien profesionale të mësimdhënësve dhe adresojnë stresin e shkaktuar nga ndryshimet në politikat arsimore. Qeveria dhe institucionet arsimore duhet të krijojnë një ambient pozitiv për shëndetin mendor të mësimdhënësve dhe të promovojnë bashkëpunimin me psikologët e shkollës për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.